

MBROJTËSI

Vëllimi VI- Nr. 3 ... drejtësi për të gjithë

www.kosovopolic.com
info@kosovopolic.com

EVIDENCE

Warning!
Portable Device
60

OPERACIONI
SIM
TO
SIM

Viti i reformave

Së bashku po e përmbylim edhe një vit të përcjellë me sfida të ndryshme e natyrisht edhe me suksese. Ky vit shënoi fillimin e reformës policore drejt përmirësimit të shërbimeve të sigurisë karshi qytetarëve të vendit me metodologjinë e re të punës.

Në kuadër të kësaj reforme policia e vendit ka filluar së aplikuari metodën e aktiviteteve policore në komunitet që nënkupton një qasje pro-aktive ose thënë ndryshe një polici që është më afër qytetarit të vendit.

Ky vit solli edhe miratimin e strukturës organizative të policisë që tani është në proces të rishikimit nga grupi punues e që pritet të përfundojë në fillim të vitit të ardhshëm. Më shumë për këtë do të mund të lexoni në intervistën me drejtorin e përgjithshëm të PK-së në këtë numër.

Përveç menaxhimit të ri policor në funksion të parandalimit të krimit, risia e këtij viti është praktika e menaxhimit dhe vlerësimit të punës sipas objektivave dhe rezultateve të arritura por edhe sipas mënyrës së shfrytëzimit të burimeve si dhe përpjekjet për krijimin e një baze të integruar të të dhënave në polici.

Si pjesë e reformës institucionale, që pritet të ndikojë në përmirësimin e performancës e po ashtu cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit, është miratimi i Planit Zhvillimor Strategjik 2011 – 2015 që u miratua këtë vit.

Në këtë plan janë identifikuar shtatë objektiva kryesore ku nevojiten angazhime dhe ngritje të kapaciteteve të Policisë së Kosovës. Këto objektiva përfshijnë: parandalimin dhe luftimin e krimit të organizuar, sigurinë publike, kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve shtetëror, zhvillimin e organizatës përmes menaxhimit të performancës, modernizimin e organizatës, anëtarësimin në organizata ndërkombëtare si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë.


Realizimi i suksesshëm i këtyre objektivave do të ketë ndikim edhe në shumë procese të rëndësishme për vendin tonë përfshirë këtu edhe atë të integritetit në Bashkimin Evropian.

Fillimi i vitit të ardhshëm pritet të shënohet edhe me përmirësimin e mirëqenies së të punësuarve në PK, marrëveshja për ngritjen e pagave e nënshkruar ndërmjet Qeverisë së vendit dhe Sindikatës së PK-së pritet të realizohet nga muaji janar i 2011-ës. Natyrisht edhe kjo temë është e trajtuar në revistë.

Në fund, duke ju uruar festat e fundvitit, falënderoj për bashkëpunim të gjithë kolegët dhe bashkëpunëtorët e jashtëm.



Arbër Beka



Buletini informativ i policisë në Kosovë është botim i PK-së

Botues

ZIMP

Zyra për Informim dhe Marrëdhënie
me Publikun e PK-së
DPP - Prishtinë

Redaktor

Arbër Beka

Tel.: 038 5080 1237

Mob.: 044 146 696

045 708 709

E-mail:

arber.beka@kosovopolic.com

arberbeka@gmail.com

revistambrojtisi@kosovopolic.com

Bashkëpunorë

Veton Vula

Fotograf

"MBROJTËSI"

Dizajni:

Çajup Kajtazi
Bashkim Perçuku

VSAT: 1046/1145

çajup.kajtazi@kosovopolic.com

bashkim.perçuku@kosovopolic.com

INTERVISTË

FAQE 4-6

Intervistë me drejtorin e përgjithshëm të PK-së, z. Reshat Maliqi
Do të forcojmë partneritetin me qytetarët

SINDIKATA

FAQE 7

Sindikata e PK-së lidh marrëveshjen për rritjen e pagave

POZITA E FEMRËS NË PK

FAQE 8-9

Pozita e femrës pjesëtare e Policisë së Kosovës

'SIM TO SIM'

FAQE 10-12

DHKEK-ja godet krimin e organizuar

ZGJEDHJET 2010

FAQE 13

KRIMI KOMPJUTERIK

FAQE 16-19

Parandalimi dhe luftimi i kriminalitetit kompjuterik

BE NDIHMON PK-në

FAQE 20-21

Në harmoni me kodin kufitar të Shengenit

MIK

FAQE 22-23

Menaxhimi i Integruar i Kufirit

ROLI I QYTETARËVE NË SIGURI

FAQE 24-25

Edhe një fushatë për rolin e KLSP-ve

ME GJERSISHT →

PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të PK-së

DO TË FORCOJMË PARTNERITETIN ME QYTETARËT

Lufta kundër krimit, përforcimi i bashkëpunimit me qytetarët, ngritja e kapaciteteve të policisë, mirëqenia, integrimi i PK-së në organizata ndërkombëtare të sigurisë, janë disa nga sfidat, prioritetet dhe detyrat që ka para vetes. Në një intervistë për 'Mbrotjesin' flet drejtori i përgjithshëm i PK-së, z. Reshat Maliqi.

Mbrojtësi: Policia ka një strukturë të re organizative, tani me rishikimin e të njëjtës çfarë ndryshimesh priten të bëhen në të dhe çfarë qasje do të ketë ndaj strukturës, qasje fleksibile apo do të konsiderohet si një strukturë e fortë që me përfundimin e rishikimit nuk do të ketë më ndryshime për vite me radhë?

Maliqi: PK-ja ka një strukturë të organizimit, tani është koha që ajo të rishikohet, për këtë unë kam caktuar një grup punues që do të bëjë rishikim dhe plotësim eventuale. Gjithashtu në këtë proces do të kemi edhe mbështetjen apo përkrahjen e Komponentës së Policisë së EULEX-it, ICITAP-it si dhe përfaqësuesve të Komisionit Evropian. Ne kemi dhënë një afat që grupi punues deri më 15 janar të përfundojë rishikimin e Strukturës dhe pas kësaj date sigurisht se do të kemi një strukturë për një periudhë më të gjatë kohore e cila do të na zgjidhë shumë çështje të brendshme organizative por edhe çështje tjera që ndërlidhen me Strukturën. Unë nuk besoj se do të ketë ndryshime të mëdha,

megjithatë kjo varet shumë nga të gjeturat e grupit punues dhe propozimet nga akterët e ndryshëm brenda PK-së si dhe institucioneve tjera përkrahëse për ne. Ne kemi pasur mundësi që deri më tani t'i identifikojmë problemet praktike në implementim të strukturës dhe adresimi i tyre do të shpie në korrigjimet e saj.

Mbrojtësi: Çfarë konsideroni si sfida për vitin e ardhshëm?

Maliqi: Policia e Kosovës edhe në vitin e ardhshëm do të ballafaqohet me sfida të ndryshme, siç janë: vazhdimin e marrjes së kompetencave nga KFOR-i në kufirin me Maqedoninë, Shqipërinë dhe me Malin e Zi, marrja e kompetencave për monumentet religjioze nga KFOR-i; luftën kundër krimit (në veçanti kundër krimit të organizuar), ndërtimi i filozofisë së ushtrimit të veprimtarisë policore në mënyrë proaktive, ndërtimi i kapaciteteve të Policisë në mënyrë të vazhdueshme përmes zhvillimit të kuadrit, forcimi i bashkëpunimit me agjensionet tjera të zbatimit të ligjit, mirëqenia e punonjësve etj. Ne akoma nuk kemi disa

përgjegjësi të cilat janë fushë ekzekutive e Policisë së EULEX-it, prandaj jemi duke punuar që këto përgjegjësi të jenë pjesë e jona. Parandalimi dhe luftimi veçanërisht i krimit të organizuar është një nga problemet që ne ballafaqohemi sikur që është problem edhe integrimi në organizata ndërkombëtare të sigurisë. Zgjidhja më e mirë ndaj këtyre problemeve është ngritja e kapaciteteve në polici në mënyrë të vazhdueshme, duke marrë parasysh ndryshimet në ambientin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe ngritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërkombëtar policor.

Mbrojtësi: A do të ketë konkurs për gradim vitin e ardhshëm?

Maliqi: Pas rishikimit të strukturës së organizimit dhe identifikimit të nevojave për të cilën është caktuar grupi punues dhe varësisht nga rekomandimet të cilat do t'i marr, atëherë e kemi shumë të lehtë se sa kemi nevojë për zyrtarë të gradave të ndryshme.

Tani për tani ne do të presim ta kemi finalizimin e Strukturës Organizative

më pastaj do të vijë deri tek vlerësimi i nevojave duke u mbështetur në këtë strukturë dhe varësisht nga nevojat do të shpallim konkursin për procesin e gradimit. Ne kemi përcaktuar një afat kohor kur do të fillojmë me proces të ri të gradimit koha do të jetë diku në muajin mars-prill.

Për të pasur një proces të gradimit me standarde të larta, konkurrues dhe transparent ne e kemi përgatitur gjithë infrastrukturën e nevojshme normative dhe tani mbetet vetëm edhe praktikisht t'i kemi kryer të gjitha punët në mënyrë që ky proces të jetë fer dhe i drejtë për të gjithë.

Mbrojtësi: Si është duke funksionuar metodologjia e re e punës dhe a ka treguar rezultate deri tani?

Maliqi: Filozofia ime e policimit është policimi i drejtuar drejt komunitetit (Community Oriented Policing), procesi i ndërtimit të raporteve të partneritetit ndërmjet policisë dhe komunitetit është esencial në policimin bashkëkohor si dhe ndikon në efektivitetin dhe efikasitetin e policisë. Praktika ka treguar se më mirë është të zgjidhen problemet dhe brengat e publikut përmes bashkëpunimit sesa përmes aplikimit të metodave tradicionale policore. Në Policinë e Kosovës kemi instaluar sistem të bashkëpunimit me komunitetin në forma të ndryshme sidomos përmes këshillave komunale dhe lokaleve të sigurisë publike. Kjo na ka mundësuar të jemi më afër qytetarëve për t'i kuptuar brengat e tyre si dhe ka mundësuar të ndërtojmë një partneritet të qëndrueshëm me institucionet e pushtetit lokal si dhe na ka mundësuar që ta zhvillojmë vetëdijësimin lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal, t'i identifikojmë brengat lidhur me sigurinë publike dhe t'i rekomandojmë planet e veprimit, për t'i adresuar këto brenga me përpjekje bashkëpunuese të autoriteteve komunale, komuniteteve lokale dhe Policisë.

Në këto njëmbëdhjetë vjet ne

kemi mundur të shohim një ndryshim të madh sa i përket aktivitetit policor në Kosovë. Derisa në fillim të ndërtimit të Policisë së Kosovës ne më shumë kemi qenë të angazhuar në reagim, tani ka ndryshuar shumë qasja jonë në drejtim të parandalimit. Ngritja e besimit tek popullata ndaj policisë është rritur në mënyrë të vazhdueshme dhe se policia ka filluar të bëhet pjesë e komunitetit. Dekoncentrimi i shumë funksioneve policore është parë si një domosdoshmëri e kohës dhe ndryshim i cili duhet të përcillet edhe në të ardhmen.

Me kalimin e kohës është vërejtur se ka nevojë për riorganizim të brendshëm, i cili do t'u përgjigjet nevojave të kohës si dhe ndërtimi i gjithë infrastrukturës legale më të gjerë për punët e policisë. Lidhur me metodologjinë e re ajo në përgjithësi ka treguar sukses, jam shumë i interesuar që te ajo të funksionojë pasi kjo është në interes të qytetarit dhe një bashkëpunim i afërt na e lehtëson punën e përditshme që e bëjmë si PK.

Mbrojtësi: A është identifikuar ndonjë mangësi në këtë drejtim (sa i përket metodologjisë së re të punës) dhe nëse po si do të tejkalohet?

Maliqi: Unë kam autorizuar kohë me parë Njësinë e Inspektimit që të bëjë një hulumtim lidhur me implementimin e strukturës organizative dhe metodologjinë e re

policore. Jam në pritje të rekomandimeve dhe nëse ka ndonjë mangësi do t'i marrim rekomandimet si t'i tejkalojmë ato.

Mbrojtësi: Kohëve të fundit ka pasur deklarata të shumta për mirëqenien e zyrtarëve policorë, a mendoni se do të ketë diçka konkrete në këtë drejtim vitin e ardhshëm?

Maliqi: Ne jemi në proces të vazhdueshëm për gjetjen e mënyrave për përmirësimin e mirëqenies së zyrtarëve policorë, respektivisht të personelit policor. Gjatë kohëve të fundit kam pasur shumë takime dhe diskutime me zyrtarët tonë përgjegjës për Financa dhe Personel krejt me qëllim të hulumtimit të mundësive për të përmirësuar gjendjen. Gjithashtu kam diskutuar këtë çështje edhe me përfaqësuesit e Sindikatës së Policisë së Kosovës si dhe me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Akoma për këtë vit nuk kemi diçka konkrete megjithatë përpjek-

jet janë maksimale për të bërë diçka në këtë drejtim. Ne presim që me buxhetin e vitit të ardhshëm të kemi mundësi më të mëdha për të përmirësuar mirëqenien e personelit policor.

Mbrojtësi: Në raportin e progres-



it të Komisionit Evropian për këtë vit ceket përveç tjerash se policia duhet të forcojë kapacitetet e “policisë së udhëhequr nga intelijenca” për të luftuar krimet serioze si dhe të përmirësojë efektivitetin në luftë kundër krimit të organizuar. Si e vlerësoni ju raportin e progresit ku në shumicën e rasteve ku përmendet PK-ja është e cekur se ka progres të limituar?

Maliqi: Përmes ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve tona në fusha të specializuara të luftimit të krimit do të ngrijmë efikasitetin në luftë kundër formave të caktuara të krimit.

Ne do të fokusohemi që duke forcuar partneritetin e vazhdueshëm me qytetarët të arrijmë t’i identifikojmë problemet dhe të adresojmë zgjidhjet për të ardhmen.

Përmes ngritjes së bashkëpunimit me policitë e rajonit, Evropës dhe më gjerë do të ndërtojmë mekanizma bashkëpunimi që do të ndikojnë në efikasitetin tonë veçanërisht në shkëmbim të informacioneve.

Organizimin e brendshëm të policisë do t’ia përshtatim nevojave dhe ndryshimeve në mënyrë që të jemi në hap me kohën. Problemet kryesore që na paraqiten sot për policimin në përgjithësi janë ecja në hap me kohën dhe përgjigjja parandaluese apo reagimi preventiv ndaj dukurive të reja të krimit dhe problemeve që janë kërcënim për shoqërinë.

Mbrojtësi: Mosha mesatare e pjesëtarëve të PK-së është identifikuar të jetë mbi 42 vjeç, a pritet të ketë ndonjë konkurs të ri apo si do të tejkalohet kjo situatë në vitet në vijim?

Maliqi: Përmirësimi i moshës mesatare të pjesëtarëve të policisë do të jetë një nga objektivat e mia. Ky proces është i varur edhe nga vlerësimi i nevojave për burime njerëzore, proces i cili ka filluar dhe është duke vazhduar. Ne jemi të sigurt se kemi nevoja më shumë për personel policor dhe kjo do të ndihmojë



që në proceset e ardhshme të rekrutimit dhe seleksionimit të përzgjidhen personel me moshë më të re dhe kështu do të fillojë edhe procesi i përtëritjes së personelit të policisë.

Për informim të opinionit në të kaluarën kriteret e punësimit kanë qenë me moshë deri 55 vjet dhe kjo sigurisht se ka ndikuar në punësimin edhe të kuadrit i cili ka pasur moshë më të shtyrë. Tani është normuar që të drejtë aplikimi kanë vetëm personat prej moshës 18 vjeçare deri 30 vjeçare dhe kjo padyshim në proceset e ardhshme do të ndikojë në zvogëlimin e moshës mesatare.

Gjithashtu në këtë proces do të ndikojë edhe çështja e pensionimit e cila besojmë se tani gjatë propozim ndryshimit të Ligjit për policinë do të adresohet në favor të interesit të organizatës.

Mbrojtësi: Kohëve të fundit është formuar një grup punues për ndryshimin e Ligjit për policinë, cilat janë mangësitë e identifikuara deri tani në këtë ligj dhe sa do të jenë të rëndësishme për PK-në këto ndryshime?

Maliqi: Grupi punues për ndryshimin e Ligjit për policinë ka vazhduar me punë kohë më parë dhe udhëhiqet nga drejtori i përgjithshëm. Nuk pres që të ketë ndryshime të mëdha. Ndryshimet

në Ligjin për policinë kanë ardhur si pasojë e ndryshimit të Ligjit të IPK-së me të cilin përgjegjësia për disiplinën do të kthehet në PK. Ndryshime tjera do të ketë në hierarkinë komanduese pas ndryshimeve që janë bërë në strukturën e re të organizimit si dhe ndryshime tjera që janë identifikuar gjatë zbatimit praktik të ligjit. Këto ndryshime do të jenë shumë të rëndësishme për punën e PK-së.

Mbrojtësi: Në fund cila do të ishte porosia juaj për të gjithë pjesëtarët e PK-së?

Maliqi: Ftoj punonjësit e PK-së në të gjitha nivelet e organizimit të tregohen personalisht përgjegjës dhe të përgjegjshëm për veprimet e veta, duke kryer të gjitha detyrat e ngarkuara me sukses. Me organizimin dhe punën tonë të fitojmë respektin e publikut, institucioneve vendore dhe ndërkombëtare si një organizatë profesioniste për mbrojtjen e ligjit dhe sigurimin e shërbimeve për komunitetin të cilit i shërbejmë. Rendi ligjor fokusohet jo vetëm në çfarë bëhet, por edhe se si bëhet prandaj të dëshmojemi edhe në të ardhmen se dimë si t’i bëjmë gjërat që të ruajmë vlerat e demokracisë që po ndërton Kosova. Të ofrojmë zbatim të ligjit në Kosovë në mënyrë profesionale, efektive dhe efikase.

SINDIKATA E PK-SË LIDH MARRËVESHJEN PËR RRITJEN E PAGAVE

Sindikata e Policisë së Kosovës që nga themelimi vazhdimisht është angazhuar për përmirësimin e mirëqenies së pjesëtarëve të Policisë së Kosovës.

Kësisoj, në kuadër të marrëveshjeve të arritura të sindikatave që bënë me kryeministrin e Qeverisë së Kosovës, edhe Sindikata e Policisë së Kosovës pas diskutimeve dhe dialogimit për ofertën që bëri kryeministri i Qeverisë së Kosovës, arriti marrëveshje me kryeministrin e Qeverisë të Republikës së Kosovës për rritjen e pagave për pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Marrëveshja u nënshkrua më 30.11.2010 nga kryeministri i Kosovës z. Hashim Thaçi dhe kryetari i Sindikatës të Policisë së Kosovës, znj. Valbona Kamberi.

Në bazë të kësaj marrëveshje të

firmosur, pagat e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës gjatë vitit 2011 do të rriten 40% (20% nga muaji Janar 2011 dhe 20% nga muaji Qershor 2011), ndërsa për periudhën katërvjeçare pagat e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës do të rriten 100%.

Sindikata e Policisë së Kosovës përshëndet gatishmërinë e Qeverisë së Kosovës për zhvillimin e dialogut social me të gjitha sindikatat, e në kuadër të kësaj edhe me Sindikatën e Policisë, si dhe mirëpret vendosmërinë e shprehur të Qeverisë së Kosovës për zbatimin e marrëveshjeve të arritura dhe të firmosura.

Sindikata e Policisë së Kosovës edhe në të ardhmen përtë gjitha çështjet jetike të pjesëtarëve të Policisë së Kosovës do të angazhohet për zgjidhjen e tyre përmes dialogut konstruktiv social.



Në bazë të kësaj marrëveshje të firmosur, pagat e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës gjatë vitit 2011 do të rriten 40% (20% nga muaji Janar 2011 dhe 20% nga muaji Qershor 2011), ndërsa për periudhën katërvjeçare pagat e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës do të rriten 100%



SINDIKATA E POLICISË SË KOSOVËS
SINDIKAT KOSOVSKE POLICIJE
KOSOVO POLICE UNION



POZITA E FEMRËS PJESËTARE E POLICISË SË KOSOVËS

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte analiza e të gjithë faktorëve duke filluar nga pjesa normative e deri në problemet bazike që femrat hasin në ushtrimin e profesionit të tyre, me të vetmin qëllim që me politika plotësuese të parandalohen këto vështirësi dhe të sigurohet ambient edhe më i favorshëm për femrat police.

Raporti mbi pozitën e femrave police në Policinë e Kosovës është raport i cili analizon legjislacionin në fuqi, statistikën si pasqyrë e përfaqësimit dhe lëvizjeve në këtë drejtim, po ashtu edhe problemet reale që femrat police hasin në ushtrimin e profesionit të tyre.

Pjesëtarët e PK-së, në fushëveprimin e tyre, si zbatues të ligjit, kanë për detyrë që përveç dispozitave të veçanta nga lëmi i sigurisë, të zbatojnë edhe dispozitat e përgjithshme, siç janë dispozitat kushtetuese dhe të ligjeve pozitive, zbatimi i drejtpërdrejtë i dokumenteve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore, siç janë p.sh. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas, Ligjin për barazi gjinore 2004/2, Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit dhe rezolutat relevante ndërkombëtare etj.

Në Policinë e Kosovës struktura aktuale gjinore, vetëm për kategorinë zyrtar policor është: nga 7331 policë sa ka gjithsej Policia e Kosovës, 6412 janë meshkuj dhe vetëm 919 prej tyre janë femra. Përkatësisht rreth 87% janë meshkuj dhe rreth 13 % janë femra. Kjo paraqet një shifër të ulët të përqindjes aktuale të femrave police në PK. Për më tepër trendi i rënies së numrit të femrave police në PK përgjatë viteve demonstroi se mundësitë e femrave police në PK nuk janë të kënaqshme.

Zyra për të drejtat e njeriut në PK publikon raportin hulumtues me të gjeturat për pozitën aktuale të femrës – pjesëtare e PK-së


Të gjeturat e këtij raporti tregojnë se nga numri i përgjithshëm i femrave në PK, 33.26 % prej tyre kanë braktisur vendin e punës, përderisa përqindja e meshkujve që kanë braktisur PK-në është 14%.

Vështirësitë që femrat hasin në ushtrimin e profesionit të polices janë të shumta, mirëpo të gjitha këto nuk janë të përfshira në intervistat e daljes (forma që zyrtarët plotësojnë në rast dorëheqje). Kjo formë nuk është e përshtatshme dhe se kategoritë të ndara si faktorë nuk janë gjithëpërfshirëse dhe nuk korrespondojnë me rrethanat aktuale. Zyra për të drejtat e njeriut e PK-së ka analizuar deklaratat dhe intervistat me një numër të caktuar të femrave police (aktive dhe ato që kanë braktisur policinë), dhe problemet që ato hasin në kryerjen e detyrës janë: ndërrimi

i natës, pushimi i shkurtër i lehonisë, pagat e vogla, mungesa e sigurimit jetësor, mungesa e avancimit në punë, puna në distanca të largëta, transporti, mungesa e ligjit të punës, ngacmimi seksual, mentaliteti i shoqërisë etj.

Në analizën e deklarimeve të mbi 350 pjesëtareve të policisë që kanë dhënë dorëheqje, duke analizuar/zbërthyer gjithashtu edhe kategorinë arsyet personale, si dhe nga analiza, dalë nga intervistat me policet, rezultojnë këto të dhëna:

Të ardhurat e pamjaf-



tueshme/pagat e vogla paraqesin problemin bazë për pjesëtarët e Policisë së Kosovës, e veçanërisht për femrat. Kjo ka ndikuar me rreth 38% të dorëheqjeve. Për femrat police në PK kjo na paraqitet si pengesë, e sidomos për nënat me fëmijë, ku për të vazhduar shërbimin në polici detyrohen të angazhojnë kujdestarë për fëmijët e tyre, gjë që vështirë ose fare nuk arrijnë ta mbulojnë me të ardhurat në PK.

Rreth 20% e femrat police pjesëtare të PK-së, kanë deklaruar si faktor, me rastin e dorëheqjes, kushtet e punës. Kushtet e punës të deklaruarat në intervistat me rastin e dorëheqjes është kuptuar si: ndërrimi i natës, sidomos për nënat me fëmijë të vegjël por edhe detyrimet tjera familjare që femrave u imponohen në familje pavarësisht profesionit, pastaj pasojnë pozita në punë, pajisjet zyrtare, përgjegjësia në hierarki etj.

Ndërrim statusi që nënkupton martesën nga të deklaruarat në intervistat e daljes. Bazuar në të dhënat, femrat pjesëtare të PK-së deklaruan se ky faktor ka ndikuar me rreth 10% në dorëheqje.

Rastet për avancim shfaqen si ndër faktorët e dorëheqjeve të femrave pjesëtare të PK-së. Ky faktor përbën 9% të deklarimeve të femrat pjesëtare të PK-së. Nga analiza del se numri i femrave në pozita udhëheqëse është fare i vogël, më pak se 10% të grave police janë në pozita udhëheqëse.

Ambienti i marrëdhënieve në shërbim, këtë faktor të dorëheqjes e kanë deklaruar gjatë plotësimit të formës "Intervista e daljes" rreth 4% nga femrat pjesëtare të PK-së me rastin e dorëheqjes. Zakonisht ky faktor ka përfshirë raportet ndërmjet kolegeve, detyrat e ngarkuara, respekti nga koleget, përkrahja në rastet kur është

kërkuar ndihma këshilluese etj.

Të tjera, në këtë kategori si faktor që ka ndikuar në dorëheqjet e femrave pjesëtare të PK-së, janë deklaruar rreth 12%, kjo kategori përfshinte nga të deklaruarat: punësimin e ri, ndërrimin e pozitës, kushtet e vështira për udhëtim, shëndetin dhe në disa raste edhe faktorët të përmendur në kategoritë e formës të "Intervista e daljes".

Vërehet se të intervistuarat në bazë të këtij raporti hulumtues, kanë hasur në vështirësi të plotësojnë formën e "Intervistës së daljes", dhe se shumë faktorë nuk janë të përfshirë në intervistën e daljes, si p. sh.: puna në distancë të largët sidomos për nënat me fëmijë të vegjël, pamundëson edhe shfrytëzimin e lehtësimeve që u garanton ligji për dy orë gjidhënie në ditë, e cila edhe në vetvetë konsiderohet e pamjaftueshme, pushimi i lehonisë, mentaliteti i shoqërisë, ngacmimi seksual etj.

Është e rëndësishme edhe sqarimi i kategorive të të punësuarve brenda Policisë së Kosovës, në mënyrë që analiza të përfshijë kushtet dhe mundësitë e performimit të profesionit me gradë police.

Policia e Republikës së Kosovës punëson dy kategori të personelit policor:

a) zyrtarë policorë, që bëjnë betimin dhe kanë autoritet t'i ushtrojnë dhe t'i kryejnë autorizimet dhe detyrat policore;

b) stafi civil që punësohet për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative, por që nuk ka autoritet të ushtrojë autorizime policore.

Derisa nuk ishte Ligji i policisë ka ekzistuar edhe një kategori e personelit policor si oficer të sigurimit, mirëpo tani kjo kategori është në përfundim të proceseve dhe procedurave të përfshirjes në kategorinë zyrtar policor.

Hulumtimi i Zyrës për të drejta të njeriut të PK-së nxori në pah edhe rekomandimet që mund të ndikojnë në përmirësimin e pozitës aktuale të femrës – pjesëtare e PK-së:

- Të hartohen programe/strategji të veçanta, të cilat inkurajojnë vajzat dhe gratë të inkuadrohen në Policinë e Kosovës, dhe të ndahet buxhet për zbatimin e këtyre programeve/strategjive;
 - Gjatë pranimit dhe regjistrimit të kadetëve në Akademinë Policore të jetë përfshirja më e lartë e gjinisë femërore; Të synohet së paku 20% e pjesëmarrjes së femrave në PK;
 - Të merren parasysh problemet që femrat police hasin në ushtrimin e profesionit dhe të luftohen ato në mënyrë që të parandalohet braktisja e punës nga femrat në PK;
 - Të aplikohen politikat avancuese për barazi gjinore në praktikë në PK, përfshirë edhe ndarjen e mjeteve financiare për aplikimin e tyre;
 - Të funksionalizohet Asociacioni i Femrave Police të Kosovës;
 - Të përkrahen policet në avancimin në punë;
 - Për rastet e ngacmimit seksual në PK do duhej të jetë shumë më strikt në ruajtjen e konfidencialitetit të informatave, si dhe të shkurtoje zinxhirin raportues;
 - Të insistohet që për rastet e ngacmimit seksual në PK, gjykatave t'u ofrohen me kohë të gjitha informatat e kërkuara, që të mos zvarriten lëndët dhe të marrë vendim sa më të shpejtë;
 - Të zgjatet pushimi i lehonisë, duke u intervenuar në politikat relevante;
 - Të ndërhyhet në "Formulari C, - Intervista dalëse", për largimin e gabimeve teknike dhe gjuhësore, dhe të kategorizohen më qartë faktorët me rrethanat aktuale, me qëllim identifikimin e faktorëve për dorëheqje dhe preventivat e dorëheqjeve;
 - Me rastin e ndërrimit të statusit-marteses, e me ç'rast duhet të bëhet edhe ndërrimi i vendbanimit, atëherë kur është e nevojshme të bëhet edhe vendimi i transferimit në dobi të femrës police;
 - Të lirohen nënat me fëmijë të vegjël nga ndërrimi i natës dhe detyrat në distanca të largëta.
- Hulumtimet ndërkombëtare dëshmojnë për rolin crucial të femrës në organet e sigurisë, fillimisht si një e drejtë e barabartë si dhe efikasiteti i pazëvendësueshëm në kryerjen e detyrës. Përfshirja e gruas në Policinë e Kosovës përkundër faktit që shpesh proklamohet si përfshirje e kënaqshme, gjithnjë në krahasim me institucionet tjera, si dhe duke marrë parasysh përpjekjen e vazhdueshme për përmirësimin e kushteve për femrat police me anë të politikave të veçanta, prapë të dhënat tregojnë se kemi një rënie të numrit të femrave police në Policinë e Kosovës. Këtë e elaboron fakti se në vitin 2006, sa ishte përfshirja e femrave në PK 15.20%, tani kjo shifër ka rënë në 14.75%. Edhe pse parimisht mund të duket si rënie e vogël 0.45%, për PK-në është brengë dhe shqetësim.

'SIM TO SIM'

DHKEK-ja GODET KRIMIN E ORGANIZUAR

Pas një hetimi për një vit e gjysmë nga Drejtoria për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit, mbi 140 zyrtarë policorë angazhohen në realizimin e planit policor të koduar me emrin "Sim to Sim" duke kontrolluar dhjetëra lokacione në rajone të ndryshme të Republikës së Kosovës

Drejtoria për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsionit (DHKEK-ja) ka filluar procesin hetimor lidhur me fenomenin Sim to Sim në koordinim të plotë edhe me Prokurorinë e Qarkut në Prishtinë para një

viti e gjysmë, kurse në mënyrë intensive është punuar gjashtë muajt e fundit duke u finalizuar me operacionin e koduar me emrin Sim to Sim.

Suksesi i këtij operacioni ndërlihet edhe me bashkëpunimin

e ngushtë me qytetarë, duke mos lënë anash as kontributin e mediave të cilat kanë publikuar disa herë shkrime dhe lajme të ndryshme për fenomenin Sim to Sim.

Me dyshimet e bazuara për krim të organizuar, tregti e ndaluar dhe vjedhje të rëndë, mbi 140 zyrtarë policorë kanë realizuar kontroll në 30 lokacione në 4 rajone, gjegjësisht në 8 qytete të Republikës së Kosovës që ka rezultuar me arrestimin e 11 të dyshuarve kosovarë shqiptarë. "Gjatë realizimit të operacionit, me dyshimin se janë përdorur për terminimin e impulseve telefonike apo siç njihet me emrin Sim to Sim policia ka konfiskuar shumë pajisje të sofistikuara të teknologjisë informative, si: softuer të ndryshëm, shtëpiza të kompjuterëve etj. Në bazë të një vlerësimi fillestar pajisjet e konfiskuara arrijnë vlerën e mbi 1 milion €. (GATEWAY) Sim2Sim është terminim i trafikut (të paautorizuar) ndërkombëtar – në ardhje, në rrjetin e operatorit mobil apo fix, ku përmes simbox/gateway/internetit VOIP, trafiku ndërkombëtar shndërrohet në lokal dhe në këtë mënyrë operatori vendor humb nga të hyrat e mundshme prej thirrjeve ndërkombëtare", - theksoi në një





AGRON NEZAJ

konferencë për media pas operacionit, drejtori i DHKEK-së, majori Agron Neza.

Personat e arrestuar me anë të veprave penale me qëllim të përftimit të kundërligjshëm kanë dëmtuar me dhjetëra miliona euro PTK-në dhe operatorët legalë të telefonisë mobile

në Kosovë.


Sipas një raporti zyrtar që posedon DHKEK-ja vlera e dëmeve të konfirmuara prej vitit 2007 deri më tani është 450.000€ në muaj që d.m.th për katër vjet vlera e përgjithshme e dëmeve arrin në 21.6 milionë euro.

Drejtoria për hetimin e krimeve

ekonomike dhe korrupsionit (DHKEK-ja) ka vazhduar procesin hetimor lidhur me operacionin Sim to Sim dhe është aktualisht duke vazhduar bashkëpunimin edhe me disa shtete të Evropës me dyshimin se rrjeti i personave të arrestuar ka pasur bashkëpunim me të dyshuar nga këto shtete të Evropës.



FORMA E THJESHTËSUAR E SIM2SIM



ZGJEDHJET 2010

Rreth 6000 zyrtarë policorë të angazhuar për të ofruar siguri në të gjitha qendrat e votimit

12 dhjetori që shënoi ditën kur u mbajtën zgjedhjet parlamentare, tregoi angazhimin e rreth 6000 zyrtarëve të PK-së në tërë territorin e Republikës së Kosovës duke ofruar siguri në 746 qendra të votimit me 2280 vendvotime.

Procesi zgjedhor vlerësohet të ketë kaluar i qetë, pa varësisht disa incidenteve të izoluar që janë raportuar në rajone të ndryshme e që nuk kanë ndikuar në mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

Edhe drejtori i përgjithshëm i PK-së, Reshat Maliqi vlerësoi lart performancën dhe profesionalizimin e treguar nga zyrtarët policorë në këtë ditë:

„Unë jam i bindur se me këtë përkushtim keni treguar edhe një herë profesionalizmin dhe vullnetin ndaj të gjitha detyrave dhe sfidave me të cilat ballafaqohemi dhe i kemi dhënë botës demokratike një imazh respektues në drejtim të qasjes ndaj proceseve që po zhvillohen në vendin tonë, krijimit të kushteve sa më optimale për mbarëvajtje të suksesshme të tërë procesit zgjedhor dhe në drejtim të ruajtjes së rendit dhe qetë-



sisë publike”, – theksoi Maliqi në një letër falënderimi e cila iu adresua tërë efektivit policor.

Edhe shefi i misionit të EULEX-it, Xavier de Marnhac përgëzoi Policinë e Kosovës për rolin e tyre në sigurimin e zgjedhjeve.

“Vëmendja e botës ishte drejtuar dje nga Kosova për të parë se a është në gjendje Kosova të organizojë zgjedhje të qeta dhe të sigurta. Dua të përgëzoj Policinë e Kosovës për profesionalizmin e treguar dhe popullin e Kosovës për pjekurinë

e tyre të lartë e cila rezultoi pozitivisht dje. Ato pak incidente që ndodhën dje u trajtuan në një mënyrë profesionale dhe duke zvogëluar tensionin, nga ana e Policisë së Kosovës të mbështetur nga EULEX-i”, -tha shefi i misionit EULEX.

REVISTA

MBROJTËSI





**POLICIA E KOSOVËS
POLICIJA KOSOVA
KOSOVO POLICE**

2011

	H	M	M	E	P	SH	D	H	M	M	E	P	SH	D	H	M	M	E	P	SH	D	H	M	E	P	SH	D	H	M							
Janar						1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18	19	20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30	31
Shkurt																																				
Mars																																				
Prill																																				
Maj																																				
Qershor																																				
Korrik																																				
Gusht																																				
Shtator																																				
Tetor																																				
Nëntor																																				
Dhjetor																																				

PARANDALIMI DHE LUFTIMI I KRIMINALITETIT KOMPJUTERIK



Dr.sc.Veton Vula

Kriminaliteti kompjuterik, për shkak të karakterit të tij specifik, rrezikshmërisë së madhe shoqërore dhe shkallës së lartë të rritjes, në masë të madhe po bëhet problem i vërtetë shoqëror dhe atë, jo vetëm në përmasa kombëtare por edhe në ato ndërkombëtare. “Kjo formë e kriminalitetit po zhvillohet me një shpejtësi aq të madhe që praktikisht nuk ka presedan. Për këtë arsye vlen të përmendet konstatimi se kjo dukuri është një “industri” e cila në SHBA zhvillohet më së shpejti. Vetëm në SHBA ka me miliona sisteme informatike e kompjuterike të cilat janë të kyçura në rrjetin kompjuterik. Vetëm transaksionet financiare të cilat barten nëpërmjet katër sistemeve kryesore të rrjetit të bankave elektronike si Fedwire, Bankwire, Chips dhe SWIFT, së bashku përbëjnë afërsisht 300 miliardë dollarë qarkullim ditor brenda shtetit dhe afërsisht 600 miliardë dollarë qarkullim ditor në trafikun ndërkombëtar. Këto shuma dollarësh, duke i llogaritur edhe ato të shteteve tjera në botë, të cilat janë në qarkullim monetar ditor, nëpërmjet rrjeteve të ndryshme të sistemeve kompjuterike, me siguri që paraqesin një provokim të madh, të cilit shumica e kriminelëve nuk do t’i



përkuleshin”.

Për këto shkaqe dhe të tjera, është e pakontestueshme nevoja për një aksion adekuat, me qëllim të parandalimit dhe luftimit të suksesshëm të këtij fenomeni të ri në shoqërinë bashkëkohore. Duke pasur parasysh, vështirësitë e parandalimit, zbulimit, sqarimit dhe provimit të veprave të kriminalitetit kompjuterik, në luftë kundër këtij fenomeni, shikuar në përgjithësi, në dispozicion janë tri lloje të mekanizmave të cilët mund t’u përgjigjen me sukses këtyre provokimeve, e këto janë: pajisjet për mbrojtje, etika dhe ligjet. Këta mekanizma kanë karakter preventiv dhe represiv. Para së gjithash përparësi në aplikimin e tyre duhet t’u jepen masave preventive në krahasim me ato represive. Në aspektin global, par-

akushtet e domosdoshme për luftimin dhe mbrojtjen e suksesshme të sistemeve kompjuterike, problemin duhet shikuar në tri nivele: atë ndërkombëtar, kombëtar dhe lokal. Sistemet globale kompjuterike dhe rrjedhja transnacionale e të dhënave dhe informatave, praktikisht kanë “hequr” kufijtë shtetërorë në kuptimin klasik, me çka u mundësohet kriminelëve kompjuterikë që nga një shtet të kryejnë vepra penale dhe pasojat t’i mbesin shtetit tjetër edhe me mija kilometra larg atij shteti. Me këtë, kriminaliteti kompjuterik, në kuptimin bukal, bëhet problem ndërkombëtar që hap rrugë jo vetëm të mbrojtjes së sistemeve informatike të vendit por në të njëjtën kohë edhe të huajat. Me këtë rast hapet edhe çështja e hetimeve ndërkombëtare, ekstradimeve dhe ndëshkimit të kryesve

të kësaj kategorie të kriminalitetit.

Lidhur me këtë çështje shumë autorë kanë trajtuar mënyrat e hartimit të një strategjie mbrojtëse, në mesin e tyre autori Petrovic konstaton se këto çështje shtrojnë nevojën e krijimit të një platforme të përbashkët, në planin e mbrojtjes së sistemeve informatike, të përkrahura nga standardet dhe orientimet ndërkombëtare, në njërën anë dhe në anën tjetër, bashkëpunim të fortë dhe koordinim të të gjithë anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare, në drejtim të modernizimit, unifikimit dhe sinkronizimit të sistemeve të tyre juridike, në fushën e kriminalitetit kompjuterik. Këto angazhime në nivelin ndërkombëtar do të mundësonin dhe do të lehtësonin luftimin dhe rregullimin e këtij problemi serioz dhe të ndërlikuar. Nëse preventiva nga kriminaliteti kompjuterik në nivelin ndërkombëtar nuk është e unifikuar dhe e harmonizuar, ligjet nacionale do të paraqesin barriera për kapjen e kriminelëve kompjuterikë dhe e gjithë kjo, pashmangshëm do të çojë në krijimin e strehimoreve të kriminalitetit kompjuterik, në të cilat kriminelët kompjuterikë do të jenë përmbi ligjet dhe imunë nga çdo ndëshkim. Çështjet e përmendura imponojnë nevojën e aprovimit të një platforme në planin e mbrojtjes së sistemeve informatike, të përkrahura nga standardet dhe normat ndërkombëtare dhe në bashkëpunim të plotë ndërmjet shteteve anëtare të organizatës botërore, në drejtim të modernizimit, unifikimit dhe sinkronizimit të sistemeve të tyre juridike në fushën e kriminalitetit kompjuterik, e cila në nivelin ndërkombëtar do të mundësonte dhe do të lehtësonte luftimin dhe zgjidhjen e këtij problemi të komplikuar. Nëse masat preventive ndaj kriminalitetit kompjuterik në nivelin ndërkombëtar nuk janë të unifikuara, të koordinuara dhe të harmonizuara në nivelin e dëshiruar, atëherë ligjet nacionale do të paraqiteshin si barriera për kapjen e kriminelëve kompjuterikë dhe

e gjithë kjo do të paraqiste një “çerdhe të kriminalitetit kompjuterik” në të cilat kriminelët kompjuterikë do të ishin përmbi ligjin dhe imunë në çfarëdo dënimi.

Në planin nacional është e nevojshme që të përcaktohen bazat e përbashkëta të sigurisë në pajtim me standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare, revidime të rregullativave ligjore, futjen e normave të reja apo modifikimin e atyre ekzistuese si dhe përshtatjen e tyre me kërkesat e kohës. Në njërin krah siguria kombëtare si koncept, konsiderohet si garantë e ushtrimit të të drejtave të njeriut e si e tillë është një nga detyrat më të rëndësishme të një shteti. Kjo garanci, sipas nenit 12 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, duhet të përmbushet nga një forcë publike e cila do të mbrojë në mënyrë të barabartë interesat e gjëra të gjithë

popullsisë dhe jo vetëm të atyre të cilëve ajo u është besuar.

Në anën tjetër, në fillim të shekullit të XXI-të, informacioni, i trajtuar në të gjitha format e mundshme, elektronike apo tradicionale, përbën një pasuri të vërtetë si për individët ashtu edhe për organizmat privatë apo shtetërorë dhe konsiderohet si një burim strategjik rreth të cilit zhvillohet ajo, që sot quhet shoqëri e informacionit. Nuk është hera e parë që teknologjia dhe inovacionet e lidhura me të janë në bazën e ndryshimeve të thella për shoqërinë: dje, me inovacionet në fushat e energjisë



dhe sot, me mënyrat e larmishme të komunikimit të njohurive dhe informacioneve nëpërmjet teknologjive të reja të telekomunikacionit. Ky koncept i shoqërisë së informacionit, si një vazhdimësi e shoqërisë industriale të disa viteve më parë, vë në qendër të saj informacionin dhe njohuritë, si dhe mënyrën e përcjelljes së tyre pa limite gjeografike dhe kohore. Teknologjitë e telekomunikacionit (dhe ndërmjet tyre më e përdorura është Interneti) duke qenë të përdorura gjerësisht, janë një vektor shumë i rëndësishëm dhe i pashmangshëm për shumicën e aktiviteteve. Ky realitet ilustrohet me vendin gjithnjë e më të rëndësishëm që po zë në jetën tonë të përditshme ajo që quhet hapësira virtuale (cyber-space), e cila po ndryshon gjithnjë e

më shumë kufijtë tradicionalë kohorë dhe gjeografikë dhe mënyrën e të jetuarit e të menduarit në ditët e sotme. Në këtë prizëm, informacioni si një motor ekonomik i zhvillimit, është një e mirë jo-materiale që kërkon një mbrojtje në lartësinë e vlerave dhe rëndësisë së tij, nga ana e individëve, organizmave dhe mbi të gjitha, të shtetit. Krimet që synojnë manipulimin, fshirjen, modifikimin, survejimin, spiunazhin e informacioneve që qarkullojnë në rrjetet e komunikimit mund të prekin direkt interesat e një individi, të një organizate, apo një shteti. Kështu, siguria e informacionit është e lidhur direkt me sovranitetin e një shteti e cila kalon nga mbrojtja e infrastrukturave kritike, e sistemeve dhe e rrjeteve, e pasurive kulturore të kombit, e të mirave materi-

ale dhe jo materiale, e përmbledhur në një fjalë të vetme, mbrojtja e vlerave. Në rrethet e ekspertëve të sigurisë, marrja në konsideratë e problematikës së sigurisë së informacionit, shpeshherë trajtohet si problem i lidhur tërësisht me një dimension teknik e shpeshherë si një demagogji apo problematikë virtuale. Fatkeqësisht, faktet i kanë dhënë të drejtë, vetëm pjesërisht kësaj mënyre të të menduarit. Në të vërtetë, këto sulme virtuale kanë pasur rezultate më se reale, me një bilanc shumë negativ për organizmat publikë apo privatë. Sa për të ilustruar, le të përmendet edhe një herë rasti i Estonisë, një shtet sovran dhe anëtar i organizmave euro-atlantike, siç përmbledhen sot rëndom në gjuhën e politikës që e konsumojmë për ditë, organizmat





e Komunitetit Evropian dhe të NATO-s. Në rastin konkret në këtë shtet, pas rrënimit së përmendores së ushtarit sovjetik nga një park i kryeqytetit të Estonisë, kishte pasuar një sulm masiv mbi infrastrukturën e informacionit të institucioneve shtetërore në Estoni dhe bëri që këto infrastrukturë informatike të ndalonin së funksionuari për një kohë të gjatë, duke krijuar kështu një kaos total në ekonominë e vendit. Ky sulm u eksplorua duke përdorur një teknikë jo shumë të komplikuar përmbajtjeje (flooding), i kryer mbi infrastrukturën estoneze, nëpërmjet kompjuterëve fantazmë (bootnets), gjë e cila mbingarkoi rrjetin kompjuterik në mënyrë të atillë, sa që ky i fundit nuk mundi ta përballonte ngarkesën dhe pushoi së funksionuari. Ministri i Mbrojtjes i Estonisë, Jaal Aavisko ka deklaruar për gazetën «The New York Times»: «Kemi të bëjmë me një situatë që prek sigurinë kombëtare, të krahasueshme me një situatë ku portet tuaja bombardohen nga deti».

Në këtë drejtim kur flitet për nivelin e tanishëm të zhvillimit të informatikës në Kosovë si dhe perspektivat që pritet t'i këtë teknologjia informatike në të ardhmen, është e nevojshme një rregullativë e fortë ligjore për problemin e kriminalitetit kompjuterik me të gjitha

format e paraqitjes së tij, e cila rregullativë duhet të jetë më e thukët se ajo që është paraparë në nenin 255 të Kodit Penal të Kosovës. Në këtë drejtim, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë Nr. 03/L-166, duke paraparë masa konkrete për parandalimin, zbulimin dhe sanksionimin e shkeljeve përmes sistemeve kompjuterike dhe duke ofruar respektimin e të drejtave të njeriut dhe mbrojtjen e të dhënave personale. Mirëpo, siç tregojnë përvojat e shteteve me sisteme të zhvilluara informatike, futja e vetëm disa normave në kodin penal, nuk do të ofrojë përgjigje në të gjitha çështjet e hapura të kriminalitetit kompjuterik. Do të ishte e nevojshme që paralelisht të aplikohet edhe qasja tjetër: vendosja e ligjit të veçantë mbi kriminalitetin kompjuterik. Duke marrë parasysh peshën e këtij veprimi kriminal, sanksionet do të duhej të ishin shumë të ashpra, nga dënimet e larta në të holla dhe dënime të gjata me burgim. Pastaj, masa administrative, si: ndalimi i veprimtarisë, largimi nga puna, nëse këto vepra janë kryer në vendin e punës. Në këtë mënyrë sanksionet, përveç dënimit të kryesve të kriminalitetit kompjuterik, do të shërbenin si masë preventive, për frikësim dhe parandalim të kryesve potencialë.

Me qëllim të përcjelljes dhe hulumtimit të kësaj dukurie do të ishte e nevojshme që statistikën kriminale të cilat mbahen në Policinë e Kosovës të zgjerohen edhe me kategorinë e kriminalitetit kompjuterik, në të cilat do të evidentoheshin të gjitha format e këtij kriminaliteti të parapara me Kodin Penal të Kosovës dhe Ligjin për parandalimin dhe luftimin e krimit kibernetikë. Këto statistika duhet të kishin karakter publik, me qëllim që të shërbejnë si pikënisje për të gjithë të interesuarit lidhur me përcjelljen, analizat dhe studimin e kësaj vepre penale. Po ashtu, duhet që të iniciohen dhe stimulohen hulumtime për studimin dhe kuptimin e kësaj forme të komplikuar të këtij fenomeni nëpërmjet projekteve hulumtuese shkencore, trajnime, seminare, me qëllim të zgjidhjes së suksesshme të këtij problemi të rëndësishëm shoqëror. Në këtë drejtim është e nevojshme që kujdes i veçantë t'i kushtohet aftësisimit profesional të të punësuarve në organet e administratës shtetërore, e para së gjithash atyre që janë të obliguar për luftimin e kriminalitetit si: Policia e Kosovës, gjykatat dhe prokuroritë publike, me qëllim të kryerjes sa më të suksesshme të funksioneve të tyre edhe në fushën e kriminalitetit kompjuterik.



NË HARMONI ME KODIN KUFITAR TË SHENGENIT

BE-ja ndihmon Policinë Kufitare të Kosovës për të zbatuar standardet evropiane

Fundi i nëntorit shënoi zyrtarisht përmbylljen e projektit të binjakëzimit të financuar nga BE-ja "Përforcimi i Sundimit të Ligjit – Policia Kufitare". Ky ishte projekti i parë i binjakëzimit në fushën e sundimit të ligjit në Kosovë. Kontrolli kufitar i Kosovës, pas implementimit të këtij projekti 18 mujor, është në gjendje të kryejë punë të standardeve evropiane, në harmoni me Kodin Kufitar të Shengenit.

Binjakëzimi është një prej instrumenteve kyçe për të ndihmuar shtetet e reja anëtare të BE-së për të plotësuar standardet e BE-së para pranimit të tyre.

Ai konsiston në dërgimin e një (apo më shumë) shërbyesve civilë nga një shtet anëtar i vjetër në administratën e vendit kandidat për një periudhë deri në dy vjet për t'iu ndihmuar atyre me zbatimin e "acquis communautaire" (organ

i ligjeve dhe rregullave të BE-së).

Melvin Asin, zëvendësudrejtor i operacioneve në zyrën ndërlidhëse të KE-së, tha: "Projekti ka vendosur standarde për kontrollin kufitar në Kosovë. Në raportin e Progresit të Kosovës 2010 është theksuar se Kosova ka bërë disa përparime sa i përket menaxhimit të kufijve. Tani për Kosovën si sfida do të jetë mbajtja e këtyre standardeve dhe përmirësimi i atyre që janë arritur deri më sot".

Projekti gjithashtu është përqendruar në sigurimin e zbatimit të Menaxhimit të Integruar të Kufijve përgjatë tërë vijës kufitare të Kosovës, përmirësimin e strukturës së Policisë së Kosovës, si dhe legjislacionit përkatës. Këtë e potencoi edhe u.d. i ndihmësudrejtorit për policinë kufitare të PK-së, Shaban Guda:

"Disa nga komponentët e projektit të

binjakëzimit që janë shumë të rëndësishëm për policinë kufitare të PK-së janë: ristrukturimi i policisë kufitare duke mundësuar që të kemi një strukturë që u përgjigjet kërkesave të kohës dhe duke u bazuar në praktikën më të mirë të BE-së, përmirësimi i infrastrukturës ligjore dhe trajnimet profesionale", –theksoi Guda duke falënderuar Komisionin Evropian për këtë projekt. Ky projekt ishte i rëndësishëm për aktivitetet policore dhe rritjen e kapaciteteve profesionale të policisë kufitare në veçanti. Janë rritur mundësitë për ndërprerjen dhe konfiskimin e mallrave të kontrabanduara dhe për parandalimin e kalimeve ilegale të kufirit. Kjo kryesisht është rezultat i trajnimeve të mbajtura për 800 oficerë të policisë dhe një numri të oficerëve të doganave të Kosovës gjatë punës së tyre të përdit-

shme. Të dhënat statistikore tregojnë se gjatë periudhës janar-shtator 2010, Policia Kufitare e Kosovës në krahasim me periudhën e njëjtë në vitin e kaluar ka shënuar rritje të performancës në fushat kyçe si për shembull: sekuestrimet e narkotikëve janë rritur nga 5 kg në 128 kg dhe sekuestrimet e duhanit janë rritur për 60%.

Ky projekt binjakëzimi ka punuar edhe në 27 udhëzime administrative në lidhje me Menaxhimin e Integruar të Kufirit, Ligjin për të huajt dhe Ligjin për policinë, ku 24 prej tyre janë në fuqi. Një e arritur tjetër e projektit të binjakëzimit ishte përpilimi i doracakut të Menaxhimit të Integruar të Kufirit për oficerët e vijës së parë. Në këtë doracak janë dhënë standardet për Kontrollin Kufitar dhe tani është në harmoni të plotë me praktikat më të mira evropiane.

Ky projekt është pjesë e një programi më të madh të BE-së që edhe përmes përmirësimit të infrastrukturës së teknologjisë informative dhe furnizimit të Policisë së Kosovës me pajisje përkrah arritjen e standardeve të BE-së në kufijtë e Kosovës.





MENAXHIMI I INTEGRUAR I KUFIRIT

Fuqizohet bashkëpunimi i institucioneve përgjegjëse për Menaxhimin e integruar të kufirit



Policia Kufitare e PK-së, Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit (AVUK) kanë realizuar një aktivitet të përbashkët për luftimin e kontrabandës dhe aktiviteteve të tjera ilegale dhe në të njëjtën kohë kjo ndikon në fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet këtyre institucioneve.

Ky aktivitet që është përgatitur në kuadër të një plani të përbashkët të agjencive përgjegjëse për MIK (Policisë, Doganës dhe Agjencisë së Veterinës dhe Ushqimit) ka për qëllim përfundimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive dhe luftimin e aktiviteteve ilegale dhe të kundërligjshme si: kontrabanda, kalimi ilegal i kufirit etj.

Aktiviteti i përbashkët në kuadër të planit të koduar me emrin "Kontrolli i rreptë" që u realizua në afërsi të pikë-kalimit kufitar në Vërmicë tregon angazhimet

konkrete në luftën kundër kontrabandës duke përfshirë edhe patrullimet e përbashkëta të policisë kufitare dhe Doganës me barkë në vijën e kaltër në Liqenin e Vërmicës.

Patrullat e përbashkëta të PK-së dhe Doganës së Kosovës kanë realizuar kontroll përgjatë vijës së kaltër, vijës së gjelbër si dhe kontroll në pikë-kalimin kufitar në Vërmicë si pjesë e realizimit të objektivave që parashihen në planin e veprimit për MIK-un.

Vetë nocioni i Menaxhimit të Integruar të Kufirit (MIK), nënkupton bashkërendimin dhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar ndërmjet të gjitha autoriteteve kompetente të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve dhe mallrave, si dhe vendosjen e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të integruar të kufirit, në mënyrë që të arrihet qëllimi i

përbashkët i kufijve të hapur, por të kontrolluar mirë dhe të sigurt.

Ky koncept u zhvillua nga Komisioni Evropian dhe parashikohet në udhëzimet MIK për vendet e Ballkanit Perëndimor, të cilat shërbejnë si bazë për zbatimin e aktiviteteve për menaxhimin e integruar të kufijve në rajon, si dhe ofron udhëzime për hartimin e strategjive kombëtare dhe planeve të veprimit për MIK. Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për MIK, ndjek udhëzimet MIK të KE për Ballkanin Perëndimor dhe përqendrohet tek tri agjencitë kryesore që kanë përgjegjësi në kufi: Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës dhe Agjencia e Veterinës dhe Ushqimit të Kosovës si dhe u referohet një sërë agjencish të tjera dhe operatorësh që janë aktivë në fushën e menaxhimit të kufirit.

Menaxhimi i integruar i kufirit dhe siguria në kufi, përbën një angazhim të veçantë në raport me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, legjisllacionin në fuqi, vep-



rimet politike dhe sigurinë kombëtare brenda vendit, si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare veçanërisht në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, strukturat tjera ndërkombëtare dhe ndërtimin e besimit me shtetet fqinje e më gjerë. Në këtë kontekst Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufirit, si dhe

hartimi i Planit të Veprimit për zbatimin e saj, parashikon arritjen e objektivave të afërta me praktikën dhe standardet evropiane, ruajtjen e paqes, stabilitetin e brendshëm dhe rajonal, si pjesë e zhvillimit të përgjithshëm, duke lehtësuar tregtinë dhe qarkullimin e njerëzve e njëkohësisht mbylljen e kufirit për të gjitha aktivitetet e kundërligjshme.





EDHE NJË FUSHATË PËR ROLIN E KLSP-ve

**Partneritet
Integrim
Zgjidhje e problemit
Siguri**

Policia nuk mund të bëjë punën e vet në mënyrë të përsosur pa përkrahjen dhe angazhimin e publikut. KLSP-të janë mekanizma nga të cilat ju mund të njoftoheni me problemet e sigurisë për zonën tuaj të përgjegjësisë. Sa më shumë qytetarë që përfshihen

për të ndihmuar në zgjidhje të problemit, puna e policisë do të bëhet më e lehtë. Ju mund të ngrini vetëdijen e publikut duke përcjellë informatat për KLSP-të dhe duke i ndihmuar ata që të përfshihen në këto forume. Muaj më herët OSBE-ja së bashku Policinë e Kosovës ka lansuar një fushatë që ka të bëjë me vetëdijesimin e opinionit të gjerë për rolin e qytetarëve në fushën e sigurisë, duke dhënë shpjegime shtesë për atë se si formohen dhe çfarë bëjnë

KLSP-të. Kjo fushatë pritet të vazhdojë edhe në fillim të 2011-ës, duke përfshirë shtypjen e shumë fletëpalosjeve dhe panove-billbordeve me mesazhe të fuqishme për rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet policisë dhe qytetarëve me fokus të veçantë në rolin e KLSP-ve. Fletëpalosja përmban të dhëna për KLSP-të, duke shpjeguar qëllimin e theme-limit të tyre, mënyrën se si mundet qytetari të përfshihet në këto komitete dhe si ofron informata të dobishme për ju si



pjesëtar i Policisë së Kosovës. Fletëpalosja është si rezultat i vazhdimësisë së projektit për njoftimin e publikut të gjerë për KLSP-të, projekt ky i iniciuar nga OSBE-ja, misioni në Kosovë. Projekti ka për qëllim të njoftojë policinë dhe publikun në Kosovë për sigurinë në bashkësi dhe për përparësitë e të pasurit forumet e sigurisë siç janë KLSP-të. Gjatë periudhës tetor-nëntor të këtij viti, dy KLSP të reja janë themeluar në komunën e Gjilanit (në Ponesh dhe në lagjen "Abdullah Presheva") dhe një tjetër është themeluar në komunën e Vitisë (në Verban) dhe njëherësh janë trajnuar edhe anëtarë të rinj nga KLSP-ja e themeluar më herët (në Vërboc) e cila gjithashtu gjendet në komunën e Vitisë. Në përgjithësi, 38 anëtarë të rinj nga 4 KLSP morën pjesë në trajnimin gjashtëditor në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtrri, trajnim ky i organizuar nga OSBE, misioni në Kosovë. Pjesëmarrës në këtë trajnim ishin 4 zyrtarë të Policisë së Kosovës, 17 shqiptarë, 14 serbë dhe 3 romë. Më 10 Nëntor 2010, përfaqësuesit nga të gjitha KLSP-të, përfshirë edhe ata nga KLSP-të e themeluara rishtazi, u takuan në Këshillin e katërt ekzekutiv të KLSP-ve në Kamenicë. Gjatë këtij takimi ata patën rastin të komunikojnë drejtpërdrejt me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Reshat Maliqin dhe me përfaqësuesin e zyrës për marrëdhënie me publikun, Arbër Beka, duke shprehur brengat e tyre për çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë.





PËRUIROHET OBJEKTI I RI PËR ADMINISTRATËN E POLICISË SË KOSOVËS

Hapja e objektit të ri për administratën e Policisë së Kosovës u vlerësua se do të shërbejë në kryerjen e obligimeve ndaj qytetarëve pa dallim

Në prezencën e shumë zyrtarëve nga MPB-ja, KFOR-i, EULEX-i, ICITAP etj. u bë përrurimi i objektit të ri të administratës së Policisë së Kosovës.

Prerjen e shiritit që shënonte përrurimin e këtij objekti e bënë ministri i Punëve të Brendshme z. Bajram Rexhepi dhe drejtori i përgjithshëm i Policisë së Kosovës z. Reshat Maliqi.

Hapësirat e reja të punës në përputhje

me standardet ndërkombëtare do të lehtësojnë punën por edhe do të ndikojnë në rezultate më të mira në punë.

Drejtori i përgjithshëm i PK-së në fjalën e tij të rastit në këtë ceremoni potencoi rëndësinë e infrastrukturës përcjellëse për PK-në:

“Ne jemi të përkushtuar vazhdimisht që me mundësitë tona buxhetore por edhe me përkrahjen e vazhdueshme

të Ministrisë së Punëve të Brendshme të krijojmë kushte sa më kualitative për punë. Objektivi ynë është që krahas hapësirave të reja të krijojmë edhe infrastrukturën përcjellëse logjistike të nevojshme, që punën të cilën e kryejmë, ta duam, ta bëjmë me të lehtë, në mënyrë që rezultatet dhe angazhimi ynë në zbatimin e ligjit dhe mbrojtjen e vlerave të qytetarëve të Kosovës të

jenë prioritet". Ai tutje theksoi se policia planifikon në kuadër të buxhetit për vitin e ardhshëm të ndërtojë stacionin jugor të Prishtinës, ndërtimin e garazheve nëntokësore në këtë kompleks, ndërtimin e objektit të policisë rajonale të Pejës, të Mitrovicës, ndërtimin e stacioneve policore në Kllokot, Partesh dhe Gorazhdevc.

Hapja e objektit të ri për administratën e Policisë së Kosovës, u vlerësua se do të shërbejë në kryerjen e obligimeve ndaj qytetarëve pa dallim. Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, vlerësoi se krijimi i kushteve të mira për punë, mundëson edhe rezultate të mira.

"Do të krijojë parakushte edhe për funksionim më të mirë edhe për rezultate të mira në punë. Uroj që të punoni edhe më shumë në mënyrë që të ofroni shërbime shumë më të mira për qytetarët dhe ai respekt dhe besim i qytetarëve për policinë të rritet edhe më shumë



dhe të jetë institucion edhe më i besueshëm", theksoi Rexhepi duke ju adresuar zyrtarëve policorë.

Në kuadër të këtij objekti gjendet edhe restoranti i cili në të ardhmen e afërt u mundëson personelit policor qasje

në ushqim dhe pije pa pasur nevojë të frekuentojnë vende tjera.

Ndërtimi i këtij objekti që është financuar kryesisht nga buxheti i konsoliduar i Republikës së Kosovës ka kushtuar 2,285.905.04 euro.



Komiteti lokal për siguri publike KLSP



Ofrimi i bashkësisë me policinë për më tepër
SIGURI, REND DHE MIRËQENIE!